



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.141/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj Kryesues Kymete Kicaj, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor-posterit në hapësirat publike, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;24.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa Anr.141/2025, e datës;23.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë, 23.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.141/2025, nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se Kandidati për deputet Halil Thaçi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka vendosur baner/posterin në pronë shtetërore në magjistralen Prishtinë- Mitrovicë më konkretisht në urën e fshatit Milloshevë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si provë fotografi të printuara.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pretendon se baneri/posteri i kandidatit për deputetë nga radhët e LVV-së, është vendosur në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë duke u bazuar në pëlqimin të vlefshëm paraprak deri me 23 janar 2025, i cili është dhënë nga pronari i pronës B.S, e cila është në përputhje me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullës Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Një gjë e tillë mund të konfirmohet edhe nga kontaktimi i pronarit.

Përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur si provë pëlqimin paraprak për vendosjen e posterit në objektin e lartcekur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, fotot e bashkangjitura, pëlqimin nga pronari i pronës, vërtetoi se vendosja e posterit nga kandidati për deputet nga radhët e Subjekti Politik LVV, është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, neni 5 Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandëve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr. 141/2025, datë;24.01.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.